UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

2021

QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS

Fjala e rektorit

Të nderuar,

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë (UIBM), ka krijuar mundësi të mëdha për të rinjtë e rajonit, të cilët duke u bërë pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë në Kosovë, njëkohësisht të bëhen pjesë e tregut të punës. Në UIBM janë të akredituara 20 programe, të cilat janë mjaft atraktive dhe të kërkuara jo vetëm brenda, por edhe jashtë vendit. Si të tilla ato paraqesin një derë të hapur për ata që duan të ecin në hap me të rejat në shkencë dhe gjithashtu në tregun global të punës. Përveç programeve, kabineteve, laboratorëve që ofrohen në UMIB, një segment tepër të rëndësishëm paraqet bashkëpunimi me kompanitë publike dhe ato private në vend. Si rrjedhojë studentët tanë mund të kryejnë praktikën në kompanitë që ndërlidhen me natyrën e studimeve, duke e zënë shpejtë hapin e teknologjisë së re. Në kuadër të Universitetit tonë, tashmë janë krijuar edhe mekanizma të tjerë në shërbim të studentëve, të cilët poashtu ndikojnë në rritjen e cilësisë së punës dhe përgatitjes së kuadrove të reja. Qendra e Inovacionit, asociacioni "Alumni", Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe Bordi Këshillëdhënës që përbëhet prej njerëzve të biznesit dhe universitetit, shpërfaqin një qasje të re për universitetin dhe për studentët. Konferencat shkencore që tashmë po bëhen tradicionale, kanë krijuar një imazh të një institucioni të mirëfilltë shkencor. Ndërsa ngjarjet, sikur "Panairi i karrierës dhe punës", po e pasurojnë kalendarin e aktiviteteve universitare dhe po hapin shtigje të reja për të gjithë ne. Këta hapa kanë bërë që UMIB-i në vitin 2019 të ngritët për 4 mijë vende në ranglistën e universiteteve botërore, për herë të parë i dyti në nivel vendi në listën e universiteteve publike. Kampusi i ri universitar ka krijuar mundësi të mëdha për të gjithë, qoftë si studentë, qoftë si mësimdhënës. Ky është një rrugëtim i përbashkët drejtë suksesit. Ju faleminderit!

QZHK | UIBM

Themelohet

Qendra për Zhvillim të Karrierës

Me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, është themeluar Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK). Qendra fillimisht do të funksionoj në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun.Rektori, Alush Musaj, tha se themelimi i Qendrës për Zhvillim të Karrierës (QZHK), në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” është një projekt tepër i rëndësishëm për studentët dhe vetë Universitetin. “Një qendër e tillë do të jetë një pikë e rëndësishme informacioni dhe ndërmjetësimi për studentët”. Ndërsa drejtori për Informim dhe Komunikim me Publikun, Ahmet Jashari, tha se kjo qendër do të ndihmoj rritjen e prestigjit të UMIB-it dhe do të krijoj mundësi për thithje të grandeve dhe donacioneve të ndryshme që kanë të bëjnë me vetë qendrën, mirëpo edhe vetë Universitetin. “QZHK do të ndihmoj studentët e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, sa i përket zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive që do t’u ndihmojnë për punësim, ofrimin e mundësisë për studentët që të fitojnë përvojë pune gjatë studimeve, ofrimin e informatave për tregun e punës, ofrimin e mundësisë për qasje në informata për studime, trajnime, seminare, ligjërata dhe aktivitete tjera”, tha ai.

Vizioni & Misioni

Vizioni

Një kulturë e gatishmërisë në karrierë në mbarë universitetin, që përgatit studentët për sukses pas mbarimit të studimeve.

Misioni

Për t'i fuqizuar studentët të zhvillojnë njohuri, përvojë dhe lidhje për të ndjekur karriera me kuptim personal gjatë gjithë jetës së tyre.

#2

UMIB zë vendin e dytë në nivel vendi në ranglistën e webometrics

QZHK | UIBM

Shërbimet tona

KËSHILLIM

Këshilltarët tanë mund t'ju ndihmojnë të mendoni se si qëllimet, aftësitë, interesat, procesi i vendimmarrjes dhe lloji i personalitetit tuaj mund të përkthehen në një karrierë.

EKSPLORIMI I PUNËS

Përdorimi i mjeteve tona online dhe konsultimi me anëtarët e ekipit për të ndihmuar në fushat e interesit të kërkimit, për të vendosur intervista informuese dhe për të gjetur praktikë ose punë.

TRAJNIME

Ne do t'ju tregojmë se si: të bëni një kërkim për punë, të shkruani rezumenë tuaj, letrën e motivimit, si dhe simulimi i intervistës për punë.

ALUMNI

Bashkëpunimi me asociacionin ALUMNI në UMIB për të rrefyer storiet e tyre të suksesit dhe përvojën.

Profili i të diplomuarëve për vitin akademik 2019/2020

UMIB



Bachelor



Master

Studentë aktiv më vitin akademik 2020/2021



Aktivitetet e Qendrës



PANAIRE

QZHK do të organizoj panaire për punë dhe karrierë, si dhe panaire virtuale të karrierës.

PUNËTORI

Punëtoritë tona përqëndrohen në eksplorimin e karrierës, mësimin përvojor dhe ndërtimin e aftësive.

TAKIME

Takimet bëhen me qëllim të rishikimit të aftësive të kërkimit të punës, praktikës, dhe bursave.

TRAJNIME

Trajnimet kanë për qëllim zhvillimin e aftësive të buta, përgatitjen për intervistë.

BASHKËPUNIMET

Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën "Teach for Kosovo"

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), përkatësisht Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) do të bashkëpunoj me organizatën "Teach for Kosovo" (TFK), në fushën e promovimit, përkrahjes, fuqizimit dhe avancimit të studentëve dhe të diplomuarve.

Marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë për Zhvillim Rajonal - Veri

Me qëllim të krijimit të mundësive me të mëdha për trajnimin e studentëve në fusha të ndryshme me interes për ngritjen e tyre profesionale, Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) do të bashkëpunoj ngushtë me Agjencinë për Zhvillim Rajonal – Veri (ARZHV).

QZHK në bashkëpunim me GIZ-in organizon webinarin "Shkathtësitë e prezantimit"

Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), në bashkëpunim me GIZ-in organizon webinarin "Shkathtësitë e prezantimit".

Panairi i Parë i Punës dhe Karrierës në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”

Organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe mbështetur nga GIZ-i, është mbajtur të enjten “Panairi i Parë i Punës dhe Karrierës” në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB). Në këtë aktivitetet kanë marrë pjesë kompani private, kompani publike si dhe janë prezantuar fakultetet e UMIB-it.

QZHK | UIBM

GIZ-i ndihmon me pajisje Qendrën për Zhvillim të Karrierës

Më qëllim të funksionalizimit të Qendrës për Zhvillim të Karrierës (QZH) në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), GIZ-ia ka dhuruar kompjuterë, projektor dhe pajisje të tjera të nevojshme. Ky donacion është realizuar në kuadër të bashkëpunimit shumë të mirë ndërmjet QZHK-së dhe GIZ-it.

Qendra e Karrierës në UEJL mbështet QZHK në UMIB

Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) do të bashkëpunoj ngushtë me Qendrën për Karrierë në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL) në Tetovë me qëllim të krijimit të mundësive më të mëdha për organizimin e trajnimeve profesionale për studentë. Për këtë u dakorduan zyrtari i QZHK-së në UMIB, Alban Fazliu dhe drejtoresha e Qendrës për Karrierë në UEJL, Burbuqe Kaprolli-Hamzai.



Filloi trajnimi për dizajn - grafik dhe web-dizajn

Në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), ka filluar trajnimi për dizajn grafik dhe web-dizajn, me rreth 50 studentë dhe të rinj të rajonit. Trajnimi është organizuar nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit – Veri (ARZHV) në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në UMIB dhe financohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

QZHK | UIBM

Në një ceremoni të organizuar në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), janë ndarë mirënjohje për pjesëmarrësit e trajnimit profesional që është mundësuar nga Agjencioni Rajonal Zhvillimor-Veri (ARZHV) dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Përveç rektorit, prof.dr.Alush Musaj, në ceremoni ishte e pranishme edhe ministrja, Vlora Dumoshi, mandej kryetari i komunës, Agim Bahtiri, kryesuesi i KK-së, Safet Kamberi dhe drejtoresha ekzekutive e ARZHV-së, Rreze Duli.



Ditë informuese për të studiuar në UMIB

Tre grupe studentësh, të organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe Parlamenti Studentor i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), kanë mbajtur të enjten ditë informuese në Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri, për të gjithë ata që duan të studiojnë në UMIB. Të interesuarit janë informuar për kushtet që ofron UMIB-i, duke nisur nga kampusi që është më i miri në vend, mandej programet atraktive që sigurojnë punësim, bursa, vazhdim të studimeve jashtë vendit etj.

QZHK | UIBM

UMIB pjesë e projektit për mobilitetit me Universitetin "Van Hall Larenstein" në Holandë

Universiteti "Van Hall Larenstein" në Holandë ka fituar një projekt për mobilitet nga Erasmus+, ku për partner ka Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), përkatësisht Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore (FTU) dhe UBT-në. Ky projekt që vlerësohet shumë i rëndësishëm për studentët dhe stafin e FTU-së, fillon më 1 shtator 2020 dhe zgjat deri më 31 korrik 2023.

Dekani i FTU-së, Milaim Sadiku, tha se me Universitetin "Van Hall Larenstein" kanë tashmë një traditë shumë të suksesshme bashkëpunimi që për fat të mirë do të vazhdoj. "Jemi shumë të lumtur që do të vazhdojmë bashkëpunimin me një universitet që na ka ofruar mundësi të mëdha për studentët dhe stafin tonë", tha ai.

Në kuadër të projektit, parashihet që në periudhën 3-vjeçare në Universitetin "Van Hall Larenstetin", të studiojnë gjithsej 32 studentë nga Kosova me kohëzgjatje prej 5 muajsh, ndërsa në Kosovë për të studiuar do të vijnë 4 studentë nga Holanda, ku do të qëndrojnë nga 5 muaj. Gjithashtu në kuadër të projektit parashihet edhe mobiliteti i stafit akademik.

Fushat e bashkëpunimit planifikohet të jenë: Teknologjia mjedisore, Teknologjia e ujit, Teknologjia ushqimore dhe qumështore, Zhvillimi socio-ekonomik etj.

Tre studentë të Ekonomikut presin të vazhdojnë studimet në një universitet teknik në Poloni

Tre studentë të Fakultetit Ekonomik (FE) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), ju kanë nënshtuar testeve të nevojshme për të fituar të drejtën që të vazhdojnë studimet për një semestër në “West Pomeranian University of Teknology” në Poloni. Kjo mundësi për studentët e UIBM ka ardbur si rezultat i bashkëpunimit ndëruniversitar në kuadër të projektit Erasmus+.

Studentët e Ekonomikut: Ariona Rushiti, Arlinda Sherifi dhe Rrezon Haziri, kanë kaluar fillimisht testin e gjuhës angleze dhe janë në proces të kompletimit të dosjeve me dokumente për regjistrimin e semestrit në “West Pomeranian University of Teknology”. Ata janë shprehur të lumtur që ju ka ofruar kjo mundësi dhe shpresojnë shumë që të realizojnë synimet e tyre.

Drejtuesit e UIBM-së vazhdimisht i kanë inkurajuar studentët dhe mësimdhënësit që të bëhen pjesë e këtyre projekteve që ofrohen nëpërmjet programit Erasmus+, apo organizatave të tjera.

Dy studente të FTU-së morën pjesë në “Konferencën e Tretë Kroate për Vlerësimin e Riskut Ushqimor”

Dy studentet e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore (FTU), Arbnora Durmishaj dhe Ylberinë Baliu, qëndruan për një javë në Osjek të Kroacisë, ku morën pjesë në “Autumn School”, të organizuar nga EFSA dhe Agjensioni Kroat për Ushqim dhe Agrikulturë. Ky aktivitet u mbajt në kuadër të “Konferencës së Tretë Kroate për Vlerësimin e Riskut Ushqimor”.

Qëllimi i konferencës dy ditore ishte shënimi i “Ditës Botërore të Ushqimit”, me një fokus të veçantë në rëndësinë e një ushqyerje të shëndetshme. Poashtu u diskutua edhe për temat lidhur me vlerësimin e ushqyerjes si bazë për vlerësimin e riskut, benefitet e një sistemi kontrolli të unifikuar, harmonizimi i mbledhjes së të dhënave, aktualitetet dhe trendet në vlerësimin e riskut dhe komunikimi me konsumatorët.

Krahas kësaj, ato kontribuuan edhe në workshopin me titull: “Kërkime mbi aplikimin praktik të vlerësimit të riskut në fushën e sigurisë ushqimore”.

Në këtë ngjarje pjesëmarrës ishin edhe ekspertë nga vende të tjera të Ballkanit si Bosnja, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia e poashtu edhe Turqia.

Dy studentë të FTU-së vazhdojnë studimet në Holandë në kuadër të programit “ERASMUS+”

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit “Isa Boletini” me universitete të ndryshme nëpër botë, studentë dhe mësimdhënës, janë duke përfituar nga projekte të ndryshme të përbashkëta. Në këtë kontekst, studentët e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, Arbnora Durmishaj dhe Petrit Idrizi, janë duke i vazhduar studimet në Universitetin “Van Hall Larenstein” në Holandë.

Ky program zhvillohet në kuadër të programit “ERASMUS+”, përkatësisht si rezultat i bashkëpunimit të Universitetit të Mitrovicës (Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore) me Organizatën e Ekspertëve të Holandës “PUM” dhe Universitetin “Van Hall Larenstein”.

KONTAKTI

Tel:
00383 28 535 725

Email:
qzhk@umib.net

Adresa:
Adresa: Rr.Ukshin Kovaçica,
40000Mitrovicë, Kosovë